



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOG

KONTRATË

Numri i kontratës: 633-22-8634-5-2-1/C597

KOMUNA E ISTOGUT, Njësia e prokurimit, te cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, zyrtar përgjegjes i prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

" Shkambi " Sh.p.k., Zona Industriale, ISTOG, me NRB 810296039 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë

LOT1- NDERTIMI I RRUGEVE XHEME AVDYLAJ DHE SELIM BRAHIMI NE SHUSHICE.

LOT3- NDERTIMI I RRUGES NE CERKOLEZ. . me numër identifikues: 633-22-8634-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **LOT1- NDERTIMI I RRUGEVE XHEME AVDYLAJ DHE SELIM BRAHIMI NE SHUSHICE. LOT3- NDERTIMI I RRUGES NE CERKOLEZ.**

Nr. I prokurimit	633-22-8634-5-2-1/C597
I brendshëm	633-22-54-5-2-1/C597

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për të dyja lotet duhet të jetë: **76 499,00 €; (me fjalë]**

Shtatëdhjetëgjashtë mijë katër çindenë të dhjetë nëntë zero zero Euro.

Çmimi për LOT 1- NDERTIMI I RRUGEVE XHEME AVDYLAJ DHE SELIM BRAHIMI NE SHUSHICE është 46.761,00 euro

Çmimi për LOT3- NDERTIMI I RRUGES NE CERKOLEZ është 29.738,00

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogarija)

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i kryerjes së punimeve

4.1 Të gjitha punimet ne bazë te kesajë kontrate do të fillojnë pas nënshkrimit të kontratës dhe planit të menaxhimit të kontratës dhe do të perfundojnë brenda **60** ditë kalendarike, bazuar ne planin dinamik te kontraktorit.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Gëzim Ademaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Musa Metaj
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	23-05-22
Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 633-22-8634-5-2-1/C597

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 “Punë” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 “Kontraktuesi” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “Menaxheri i Projektit” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t’i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “Çmimi Kontratës” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “Vendi i ndërtimit” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “Pajisjet e kontraktuesit” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “Skicat” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguresve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6

Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7

Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë rrealizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 633-22-8634-5-2-1/C597

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës, me vlefshmëri 30 ditë me gjatë se perfundimi i kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishte do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishte do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishte pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit-Pas nënshkrimit të kontratës.</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>2 MUAJ, pas datës së nënshkrimit te planit te menaxhimit te kontratës</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha punët janë <i>0.25%</i> për çdo ditë vonese, por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxher i Kontratës është Kompanija mbikqyrese “PMN” SHPK NPN & “UNIVERS-MI” nga Prishtina e <i>cila do ta bëjë mbikqyrjen dhe realizimin e projektit deri ne perfundimin e tijë, si dhe do te punojnë planin për menaxhimin e kontratë, bazuar ne kontratën e AK-Nr. 633/22/6174/221 datë 28.07.2022</i>
Pagesat	24	Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Pagesat do te behen pas situacioneve për punët të përfunduara, ndërsa pagesa perfundimtare behet pas pranimit te gjitha punimeve pa verezjte.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>3 ditë</i> pas nënshkrimit të kontratës.
Zgjidhja miqësore e	42.2	Palët do të provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet

mosmarrëveshjeve		ku do të organizojnë se paku (2) dy takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane sukses, atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike

KOMUNA E ISTOGUT					
TITULLI I AKTIVITETIT					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA-Asfaltimi i rrugëve në Shushicë=Lagja Avdylaj L=820m d=3m dhe L=210m dhe d=3m					
	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
Punët përgaditore					
1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritët kosto e përpilimit të planit dhe programit punës si dhe gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punës si dhe akomodimi i perkohshëm i tyre	copë	1	500.00	500.00
3	Demolimi i rrethojave metalike prej telave me gjemba dhe demolime të tjera të mundshme si shtylla etj, ngarkimi dhe bartja deri në deponinë e qytetit deri në 5km distancë	copë	1	500.00	500.00
4	Largimi shkurreve dhe drunjeve me trashësi 0-40cm përgjatë trasës së rrugës për pjesë ku ka nevojë të hapet mëdha	m ³	300	1.00	300.00
5	Sanimi i trasës para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit	m ²	1030	1.00	1,030.00
				subtotali	2,330.00
2	Punimet e dheut				
2.1	Germimi i dheut të kategorisë III-IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 5km. Germimi të bëhet në thellësi deri në 25cm	m ³	1,030	3.5 €	3,605.0 €
2.2	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje me vibrocilinder deri në 30MN/m ²	m ²	4,120	0.3 €	1,236.0 €
2.3	Punimi i bankinave me trashësi t=10cm dhe gjerësi 0.5m me zhavor 0-31.5mm me ngjeshje- duke përfshirë përfshirë udhëkryqet dhe rrugët lidhëse me bankinën e rrugës	m ³	103	10.0 €	1,030.0 €
2.4	Furnizimi dhe vendosja e gypit polietilen për kullim-depertim të rrugës, në dy vend PSN8 Ø315mm. dhe punimi i kokave nga betoni	m ³	8	20.0 €	160.0 €
2.5	Ngritja e pusëve të kanalizimit, punimi i kokave të tyre. Në llogari të parashihet edhe vendosja e kapakeve nga Giza me aftësi mbajtëse 40Ton	copë	2	100.0 €	200.0 €
				subtotali	6,231.0 €
3	Mbistruktura				
3.1	Punimi i tamponit 45MN/m ² prej gurit të thyer gelqeror Ø=63mm me trashësi t=15cm	m ³	618	10.0 €	6,180.0 €
3.2	Punimi i tamponit 60MN/m ² prej gurit të thyer gelqeror Ø=32mm me trashësi t=10cm	m ³	412	10.0 €	4,120.0 €
	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e Asfalt betonit 0-16mm me trashësi t=7cm për tërë sipërfaqen e rrugës dhe atë me gjerësi 3m dhe 3.5 sipas përshkrimit	m ²	3,100	9.0 €	27,900.0 €
				subtotali	38,200.0 €
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT (GJITHSEJ 1+2+3)					46,761.0 €

ASFALTIMI I RRUGËVE NË SUHOGERLË - KOMUNA E ISTOGUT					
ASFALTIMI I "RRUGËVE NË Suhogerllë (Lagja Veselaj L=180,b=3 m,(Zgjerim 40m2) L1=80,b=3 m L2=120,b=2.5m Lagja Jasharaj-Imcraj L300m.b=3m(zgjerimet 20m²)					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Gjatësia e rrugës		L=680m	Gjërësia e asfaltit :		B=3m dhe b=2.5
		Gjërësia e germimit			b=4m
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				1,180.0 €
1.1	Mobilizimi i ndermarjes dhe rregullimi i punishtes per pune si dhe largimi i instalimeve te ndryshme (elektrike, uji dhe kanalizimi, ptk, kablovike etj) ne punishte ne rast se ka ne ato hapesira dhe dislokimi i tyre ne vendet e caktuara nga institucionet perkatese. Te gjitha angazhimet dhe shpenzimet per dislokimin dhe rikyqjen e instalimeve ne rrjetin te qytetit i bart operatori ekonomik.	copë	0.00		0.00 €
1.2	Vendosja e shenjave te perkohshme vertikale dhe shenjave per kontrole te trafikut gjate kryerjes se punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjate punimeve.	copë	0.00		0.00 €
1.3	Shenimi i trasese si dhe percjellja e punimeve me matje gjeodezike gjate egzekutimit.	m'	680.00	1.00 €	680.00 €
1.4	Pastrimi i terenit ne pjeset anesore te ruges ne te dyja anet e saj nga shkuret, rrenjet e drunjeve egzistues si dhe ndonje pengese eventuale (gardhet) etj.	m'	500.00	1.00 €	500.00 €
2	PUNËT TOKËSORE				3,356.0 €
2.1	Gërmimi i dheut te kategoris se III dhe IV me trashesi t=25cm, dhe bartja e materialit te germuar deri ne deponi me te afert.	m3	680.00	3.00 €	2,040.00 €
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazes se rruges në tërë gjatësinë e saj me saktesi deri ne 2cm me grejder me modul te ngjeshjes 30-35MPa.	m²	2,720.00	0.30 €	816.00 €
2.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave prej betoni fi 400/1000mm, m sipas nevojë ne teren per punimin e lesheses. Ne kete position llogariten edhe kokat hyrëse dhe dalese. Vendosja e armatures rrjete Q-378 (Ø8.5/15/15) si dhe furnizimi dhe vendosja e betonit te lesheses, (pllake mbi tubacion b=1.0m dhe t=10cm) qe e trupon rrugen me beton te klases C-30/37.	m'	10.00	50.00	500.00 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS				25,202.0 €
3.1	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granular nga guri i thyer (0-63mm) me trashesi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne moduln e ngjeshjes 50-60Mpa.	m3	408.00	8.00 €	3,264.00 €

Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
3.2	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushës zhavorik të granulluar nga guri i thyer (0-31.5mm) me trashësi pas ngjeshjes t=10cm , ngjeshja të bëhet me cilindër 25tone deri në modulën e ngjeshjes 80Mpa.	m3	272.00	9.00 €	2,448.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit me asfaltbeton AB-16 , me trashësi 7cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e asfaltit >2mm...45-82.5%, fraksionet e agregatit <2mm...27-49%, pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm...3-6%, përqindja e fllerit ndaj agregatit 4-10%, materiali lidhës - bitumen B50/70...5.3-6.5% dhe shkalla e ngjeshjes >97%. Garancioni i qendrueshmerisë së asfaltit duhet të jetë minimum 5 vjeçar prej ditës kur është bërë pranimi teknik i punimeve.	m2	2,040.00	9.00 €	18,360.00 €
3.4	Ngritja e pusëtave të kanalizimit, punimi i kokave të tyre. Në llogari të parashihet edhe vendosja e kapakeve nga Giza me aftësi mbajtëse 40Ton	copë	2.00	100.00 €	200.00 €
3.5	Marja e mostrave të asfaltit për shqyrtim nga një laborator të caktuar nga autoriteti kontraktues (menagjeri i projektit) në vendet e caktuara poashtu nga menagjeri i projektit.	copë	5.00	50.00 €	250.00 €
3.6	Furnizimi me material, transporti dhe shtruarja e bankinave në dy anët e rrugës me gjerësi nga 0.5m me trashësi 10cm pas ngjeshjes nga guri i thyer me fraksion (16-31.5mm).	m³	68.00	10.00 €	680.00 €

I. REKAPITULIMI		
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN	1,180.0 €
2	PUNËT TOKËSORE	3,356.0 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS	25,202.0 €
I. TOTALI (1+2+3):		29,738.00 €